



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

19-020/04-165373/123 më 11. 08. 2023

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 5, paragrafi 5.2 të Ligjit për ndërmarrjet publike 03/L - 087 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 31/15, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE PËR
NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE "Prishtina Parking" SH.A.

1. **Fadil Aliu**, caktohet anëtar në komisionin komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale të Komunës së Prishtinës "Prishtina Parking" SH.A.
2. Anëtari i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, së bashku me dy anëtarët të cilët i emëron Kuvendi i Komunës, e përbëjnë komisionin komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Prishtina Parking" SH.A.
3. Anëtari i komisionit komunal të aksionarëve, i caktuar me këtë vendim, ka të drejtë të veprojë në emër të Kryetarit të Kryeqytetit.
4. Veprimet e anëtarit të komisionit komunal të aksionarëve duhet të jenë në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike, Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjit për shoqëritë tregtare.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

